



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 01/63

Datë: 03.09.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shtator 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, Qeveria e Republikës së Kosovës do të përfaqësohet me këtë ekip negociator:
  - 1.1. Fatmir LIMAJ - Kryesues;
  - 1.2. Enver HOXHAIJ - Zëvendëskryesues;
  - 1.3. Behxhet PACOLLI - anëtar;
  - 1.4. Dardan GASHI - anëtar;
  - 1.5. Mahir YAGCILAR - anëtar;
  - 1.6. Avni ARIFI - anëtar.
2. Po ashtu në këtë ekip rezervohen vendet për përfaqësuesit e opozitës:
  - 2.1. Përfaqësues nga LDK;
  - 2.2. Përfaqësues nga VV;
  - 2.3. Përfaqësues nga PSD;
  - 2.4. Përfaqësues nga Alternativa;
  - 2.5. Ekspert nga Shoqëria Civile.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin t'ia dërgojë Kuvendit për aprovim.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/63

Datë: 03.09.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shtator 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 03/63

Datë: 03.09.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shtator 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Përfundimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 06-P-060 të datës 22 qershor 2018, paraqet mendim lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës.
2. Ky vendim, bashkë me mendimin dhe materialin përcjellës lidhur me Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi, i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/63


Datë: 03.09.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shtator 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Përfundimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 06-P-069 të datës 23 korrik 2018, paraqet mendim lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.
2. Ky vendim, bashkë me mendimin dhe materialin përcjellës lidhur me Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi, i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**



Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 05/63

Datë: 03.09.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shtator 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndahen mjetet financiare në shumën prej 25,000.00 (njëzetepesëmijë) euro për përkrahje të njëzetepesë (25) shoqatave të familjeve të personave të zhdukur.
2. Nga mjetet financiare të parapara sipas pikës 1. ndahen nga 1,000.00 (njëmijë) euro për secilën shoqatë aktive të familjeve të personave të zhdukur, për përkrahje të aktiviteteve për shënimin e ditëve të veçanta dhe funksionimin e shoqatave.
3. Mjetet financiare të parapara sipas pikës 1. të këtij vendimi ndahen nga buxheti për shpenzimet e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere dhe barten në llogaritë bankare të shoqatave të familjeve të personave të zhdukur.
4. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 06/63

Datë: 03.09.2018


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 12 paragrafi 3 të Ligjit nr. 04/L-092 për Personat e Verbër, të Ligjit nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, të nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shtator 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 20,400 (njëzet mijë e katërqind) euro për rehabilitimin e Personave me Aftësi të Kufizuar.
2. Mjetet financiare në shumën prej 18,400 euro do të barten tek Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar në nr. e xhirollogarisë 1110340431000165 dhe si më poshtë Forumi obligohet të transferojë mjetet tek shoqatat përbërëse si vijon:
  - 2.1. Shoqata "HandiKos" në shumën 2300 (dymijë e treqind) euro për rehabilitimin e 10 personave me aftësi të kufizuar;
  - 2.2. "Shoqata e të Verbërve të Kosovës" në shumën 2300 (dymijë e treqind) euro për rehabilitimin e personave me aftësi të kufizuar;
  - 2.3. "Shoqata Kosovare e të Shurdhërve" në shumën 2300 (dymijë e treqind) euro për rehabilitimin e personave me aftësi të kufizuar;
  - 2.4. "Down Syndrome Kosova" në shumën 2300 (dymijë e treqind) euro për rehabilitimin e personave me aftësi të kufizuar;
  - 2.5. "HandiKEP" në shumën 2300 (dymijë e treqind) euro për rehabilitimin e personave me aftësi të kufizuar;
  - 2.6. "Autizmi" në shumën 2300 (dymijë e treqind) euro për rehabilitimin e personave me aftësi të kufizuar;
  - 2.7. "Opfakos" në shumën 2300 (dymijë e treqind) euro për rehabilitimin e personave me aftësi të kufizuar;
  - 2.8. Klubi "Dëshira" në shumën 2300 (dymijë e treqind) euro për rehabilitimin e personave me aftësi të kufizuar.
3. Mjetet financiare në shumën prej 2000 (dymijë) euro do të barten tek Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë të cilat do të jenë në dispozicion për aplikimin e organizatave të cilat nuk janë pjesë e Forumit Kosovar të Aftësisë së Kufizuar.

4. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programin Shpenzimet e Paparashikuara, me kod 13100, kategoria e shpenzimeve Rezervës, nën kategoria ekonomike e Rezervës me kod 38010 në shumë prej 18,400 (tetëmbëdhjetëmijë e katërqind) euro dhe transferohen në Ministrinë e Financave, nën programi i thesarit me kod 11200, kategoria e shpenzimeve subvencionet dhe transferet, nën kategoria ekonomike subvencionet për entitetet jopublike me kod 21200. Këto mjete transferohen në xhironlogarinë e Forumit Kosovar të Aftësisë së Kufizuar 1110340431000165.
5. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për zbatimin e këtij vendimi.
6. Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar obligohet që të raportojë tek Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**



Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/63

Datë: 03.09.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën me nr. protokoli 2199/2, të datës 24.07.2018, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shtator 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Plani i Punës i Zyrës së Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport për periudhën korrik 2018 - qershor 2019.
2. Obligohen institucionet kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 08/63

Datë: 03.09.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shtator 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për Pagat në Sektorin Publik.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 09/63


Datë: 03.09.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shtator 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për Zyrtarët Publikë.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 10/63

Datë: 03.09.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shtator 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 11/63

Datë: 03.09.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shtator 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Financim midis Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Ekonomisë Digjitale të Kosovës.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 12/63

Datë: 03.09.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, dhe paragrafit 2. neni 14 të Ligjit Nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shtator 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport - Zyra e Kryeministrit për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 200,000.00 € për aktivitetet dhe nevojat e implementimit të Programit Nacional për Rininë për vitin 2018.
2. Mjetet financiare në shumë prej 200,000.00 euro merren nga Ministria e Financave me kod 201, nën programi Kontigjencat, me kod 28900 nga kategoria e shpenzimeve Subvencione dhe transfere dhe transferohen në Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232, nën-programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria e shpenzimeve e rezervës.
3. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi merren nga Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232, nën-programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria e shpenzimeve e rezervës në shumë prej 200,000.00 euro dhe transferohen në Zyrën e Kryeministrit me kod 104, në nën programin e Kabinetit të Kryeministrit me kod 10700 në kategorinë e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere në shumë prej 140,000.00 € dhe në kategorinë e shpenzimeve Mallra dhe Shërbime në shumë prej 60,000.00 €.
4. Obligohet Ministria e Financave dhe Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 13/63

Datë: 03.09.2018


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën e MMPH-së me nr. prot. 3691/18, të datës 23.08.2018, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shtator 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R**

1. Aprovohet shpronësimi për interes publik i pronës së paluajtshme nr. 871-1, Zona Kadastrale Krushë e Madhe, Komuna Rahovec, me qëllim të shëndrrimit të saj në Shtëpi Muze "Ukshin Hoti" për ruajtjen e vlerave historike të trashëgimisë kulturore të Kosovës, sipas tabelës pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelat pjesë përbërëse e këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit, sipas tabelave të vlerësimit në "Shkresë përcjellëse e Aktit të Vlerësimit" Nr. Protokolli 3468/18 datë 13.06.2018.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e cekura në këtë vendim.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas aprovimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat pjesë përbërëse të këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.



6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.
7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra kadastrale është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 14/63


Datë: 03.09.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 9, 10, 44 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shtator 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M P R E L I M I N A R**

1. Aprovohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme (ish shoqërore KBI "Ereniku") të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit - Ndërtimi i "Zona e Veçantë Ekonomike Amerikane", Zona Kadastrale Gjakovë, Komuna Gjakovë, sipas tabelave të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela paraqesin pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit/MMPH që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtit ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.
3. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Zyra e Kryeministrit, Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe Komuna e Gjakovës.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

**Ramush HARADINAJ**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 15/63

Datë: 03.09.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 9, 10, 44 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shtator 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M P R E L I M I N A R**

1. Aprovohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme "Objektit Afarist - Përdhesë" ish Barnatorja e qytetit Prishtinë, të cilin aktualisht është duke e shfrytëzuar Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, Zona Kadastrale Prishtinë, Komuna Prishtinë, për nevoja të akomodimit të institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës, sipas tabelave të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela paraqesin pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit/MMPH që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.
3. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe Ministria e Administratës Publike.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 16/63

Datë: 03.09.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 8, 44 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shtator 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim shtesë për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Autostradës Prishtinë-Han i Elezit, Komuna Graçanicë (zonat kadastrale: Preoc, Dobratin, Suhudoll, Uglarë), Komuna Lipjan (zonat kadastrale: Lipjan, Babush i Muhaxherëve, Konjuh, Smallushë, Marec, Gadime e Ulët, Gadime e Epërme), Komuna Ferizaj (zonat kadastrale: Babush i Sërbëve, Cërnillë, Mirash, Rahovicë, Papaz, Sazli, Softaj, Pojatë, Talinoc i Muhaxherëve, Bibaj, Fshati i Vjetër, Komogllavë, Gërlicë, Rakaj, Sojevë), Komuna Kaçanik (zonat kadastrale: Koxhaj, Soponicë, Rekë, Nikaj, Biçec, Doganaj, Kaçanik i Vjetër, Kovaqec, Bob, Gajre, Gjurgjedell), Komuna Hani i Elezit (zonat kadastrale: Neqavc, Hani i Elezit, Pustenic dhe Paldenicë, sipas tabelave të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela paraqesin pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Financave.
4. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 17/63


Datë: 03.09.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 8, 14, 44 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, të nenit 31 dhe 33 të Ligjit për Miniera dhe Minerale të Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shtator 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat janë të nevojshme për sigurimin e të drejtës sipërfaqësore për të ushtruar programin e vet të shfrytëzimit për aktivitet minerar Kompania BISEK-Sh.P.K nga Polonia, sipas Lisencës së Hulumtimit të lëshuar nga KPMM, në Zonat Kadastrale Dubovc dhe Galicë, Komuna Vushtrri, sipas tabelave të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela paraqesin pjesë përbërëse të këtij vendimi,
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Mjetet financiare për kompensimin e pronave të pronarëve, procedurës së shpronësimit, vlerësimit dhe obligimeve që do rrjedhin nga Gjykatat e Kosovës do të sigurohen nga Kompania "BISEK" Sh.P.K me seli në Poloni.
4. Vlera e saktë e vlerësimit të pronave, procedurës së vlerësimit dhe shpronësimit do t'i dërgohet Kompanisë "BISEK" Sh.P.K, para miratimit të Vendimit Preliminar.
5. Departamenti i Shpronësimit nuk do t'i propozojë Qeverisë së Kosovës miratimin e Vendimit Preliminar dhe Përfundimtar nëse Kompania "BISEK" Sh.P.K nuk depoziton shumën e mjeteve financiare në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK), e cila do të përcaktohet sipas pikës 3 dhe 4 të këtij vendimi.

6. Prona e shpronësuar do të bartet në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës e cila pastaj pas pagesës së shpronësimit nga Kompania "BISEK" Sh.P.K, do t'i bartet të drejtat sipërfaqësore parashtruesit të kërkesës për Lisencë, konform nenit 14 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme dhe Ligjit për Miniera dhe Minerale të Kosovës.
7. Obligimet e Kompanisë pas kryerjes së procedurës së shpronësimit dhe marrjes në shfrytëzim të drejtës sipërfaqësore në tokën e shpronësuar, do të përcaktohen sipas Ligjit për Miniera dhe Minerale të Kosovës.
8. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), Ministria e Financave, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komuna e Vushtrrisë.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Ramush HARADINAJ  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 18/63

Datë: 03.09.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shtator 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Borxhin Shtetëror.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 19/63

Datë: 03.09.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shtator 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Fushën e Bashkëpunimit Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Civile.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**



Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 20/63

Datë: 03.09.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke iu referuar kërkesës së Ministrisë së Administratës Publike të datës 09.08.2018, nr. protokoli 2575, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shtator 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Administratës Publike për dhënien e pajtimit për përjashtim nga fushëveprimi i Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.
2. Qeveria pajtohet që të përjashtojë nga fushëveprimi i këtij ligji, për shkak të sekretit të ligjshëm dhe interesat e sigurisë së Republikës së Kosovës, kërkesën me nr. ref. 07-502-2018 të datës 13.07.2018, për implementimin e projekteve për nevojat e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës.
3. Obligohet Ministria e Administratës Publike dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

*Ramush Haradinaj*  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 21/63

Datë: 03.09.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke iu referuar kërkesës së Ministrisë së Administratës Publike të datës 09.08.2018, nr. protokoli 2576, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shtator 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Administratës Publike për përjashtim nga fushëveprimi i Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, për Projektin "Ngritja e Kapaciteteve të Sigurisë Kibernetike në Infrastrukturën Shtetërore të Teknologjisë Informative".
2. Obligohet Ministria e Administratës Publike dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 22/63

Datë: 03.09.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 shtator 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 100,000.00 (njëqindmijë euro për Institutin Ndërkombëtar për Inteligjencë të Jashtëzakonshme ATOMI (Instituti ATOMI), për realizimin e Projektit ATOMI, i cili merret me identifikimin dhe përkrahjen e nxënësve me inteligjencë të jashtëzakonshme në mbarë Republikën e Kosovës.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen prej buxhetit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, nga linja buxhetore ekzistuese për këtë qëllim: "Përkrahja e nxënësve me potencial të jashtëzakonshëm intelektual", me kodin e nën programit nr. 98300 - kodi funksional 0922. Mjetet financiare barten në xhirollogarinë bankare të Institutit ATOMI në Raiffeisen Bank, me emër xhirollogarie: ATOMI, me numër xhirollogarie: 150 109 000 345 2594.
3. Obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë